

**AKT I THEMELIMIT DHE STATUTI  
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TE KUFIZUAR  
"ALBA-ROAD" shpk**

Në këtë statut:

- "Ligji" është Ligji Nr. 9901, dt. 14.04.2008 "Per Tregtarët dhe Shoqëritë tregtare";
- "Statuti" është Statuti i Shoqërisë;

**Kreu I**

**Themelimi, Zoterimi, Objekti, Kohëzgjatja, Selia**

**Neni 1**

**Data e Themelimit, Emri dhe Ortakët Themelues**

1.1 Themeluesit kanë krijuar nje shoqëri me përgjegjësi të kufizuar e quajtur "ALBA-ROAD" shpk.

1.2 Themeluesit e shoqërise janë:

- Neritan Malo, me Nr.ID G91002134O lindur në Elbasan , më 02.10.1969 madhor dhe zotësi të plotë për të vepruar.
- Konstantinos Ydraios, me Nr.ID AN105841 lindur në Athine, Greqi , më 11.03.1965 madhor dhe zotësi të plotë për të vepruar.
- Stylianos Ydraios, me Nr.ID AO 629608 lindur në Pire, Greqi , më 15.03.1968 , madhor dhe zotësi të plotë për të vepruar.
- Mirela Malo, me Nr.ID AH 616150 lindur në Elbasan, më 24.01.1968, madhor dhe zotësi të plotë për të vepruar.

**Neni 2**

**Objekti**

Shoqëria do të kryejë aktivitetin e mëposhtëm:

Import eksport materiale ndertimi, lende te para etj. Prodhim, perpunim polisteroli. Tregtim me shumice e pakice te produkteve termoizoluese, hidroizoluese. Punime speciale ndertimore me materiale termo e hidroizoluese. Pjekje bluarje e tregtim i kafese. Gjithashtu, shoqeria mund te kryejë çdo aktivitet tjetër plotësues dhe ndihmes që ka si qëllim ofrimin e cdo shërbimi tjetër dhe kryerjen e çdo aktiviteti tjetër, në rast se rezultojnë të dobishme dhe/ose të nevojshme për përmbushjen e objektit krvesor. Me qëllim realizimin e objektit të saj, me vendim të Asamblesë së Përgjithshme, Shoqëria mund të zotërojë në mënyrë të drejtperdrejte ose të terthorte, aksione ose pjesëmarrje në shoqëri të tjera shqiptare dhe/ose të huaja. Shoqëria, me miratimin e Organit të Administrimit dhe me qëllim realizimin e objektit të saj, mund të marrë pjesë në çfaredolloj marrëveshje tregtare dhe/ose joint venture me shoqëri dhe ndermarrje të tjera si edhe të kryejë çdo akt tjetër të nevojshëm. Shoqëria mund të lidhë kontrata qiraje, shitblerje, marrëveshje për vendosje hipoteke mbi pasuri të paluajtshme, marrëveshje huadhenie ose financimi, marrëveshje për ofrimin e shërbimeve dhe çdo marrëveshje tjetër që konsideron të nevojshme dhe/ose të dobishme për përmbushjen e objektit të saj. Transport të mallrave për nevojë të aktivitetit dhe transport të punonjesve.

**Neni 3**

**Kohëzgjatja**

3.1 Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë me afat të pacaktuar.





#### **Neni 4**

##### **Selia**

4.1 Selia e shoqërisë ndodhet në adresën "Ish Kombinati Metalurgjik, zone kadastrale nr.3965, nr.pasurie 913, Elbasan."

Adresa dytësore te shoqërisë: Elbasan Elbasan ELBASAN Lagjja Luigj Gurakuqi, rruga "11 Nentori", pallati nr.44, hyrja B. Vlore Vlore VLORE Rruga "Lef Sallata", Vlore, Pasuria nr. 24/29-N1, Zona Kadastrale nr 8603 vol 22, fq 130 (njesi) Tirane Kashar KASHAR Autostrada Tirane Durres km 4, Rruga Pavarsia nr.127. Elbasan Elbasan ELBASAN Lagjja Luigj Gurakuqi, rruga 11 Nentori, pallati 44, hyrja B Elbasan Elbasan ELBASAN Ish Kombinati Metalurgjik, Zone Kadastrale Nr.3965, Numer Pasurie 913, Elbasan Vlore Vlore VLORE Lagjja Lef Sallata, rruga Paqes 4 Tirane Kashar KASHAR Autostrada Tirane-Durres km. 4, Rruga Pavarsia, Nr. 127

4.2 Asambleja e ortakëve mund të hapi ose të mbylli adresa dytësore, filiale, zyra përfaqesimi ose degë, zyra në Shqipëri ose jashtë.

## **Kreu II**

### **Kapitali**

#### **Neni 5**

##### **Kapitali themeltar**

5.1 Kapitali themeltar i shoqërisë përbëhet nga 4(katër) kuota me vlerë prej 320,000,000 lekë (treqind e njëzet milion) lekë.

5.2 Pjesëmarrja e themeluesve në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributet e tyre të mëposhtme:

- Neritan Malo titullar i 1(një) kuotë me vlerë prej 96,000,000 lekë që përbën 30% të kapitalit të shoqërisë.
- Konstantinos Ydraios titullar i 1(një) kuotë me vlerë prej 96,000,000 lekë që përbën 30% të kapitalit të shoqërisë.
- Stylianos Ydraios titullar i 1(një) kuotë me vlerë prej 96,000,000 lekë që përbën 30% të kapitalit të shoqërisë.
- Mirela Malo titullar i 1(një) kuotë me vlerë prej 32,000,000 lekë që përbën 10% të kapitalit të shoqërisë.

5.3 Shoqëria mund të krijojë rezerva nga fitimet vjetore sipas rastit, pas zbritjes së shpenzimeve vjetore dhe detyrimeve.

#### **Neni 6**

##### **Kërkesa për të paguar kuotat dhe anulimi i kuotave të papaguara**

6.1 Administratori u kërkon ortakëve të shoqërisë pagesën e kontributeve të pashlyera në lidhje me kuotat e tyre dhe çdo ortak (pas marrjes së njoftimit prej 14 (katërmëdhjetë) Ditësh të Plota në të cilin percaktohet koha dhe vendi i kryerjes së pagesës) i paguan shoqërisë shumën e kërkuar për kuotat e zotëruara. Njoftimi për pagesë mund të parashikojë shlyerjen me këste të kontributeve të papaguara. Personi të cilit i drejtohet njoftimi për pagesën e kontributit do të jetë përgjegjës për njoftimet që i drejtohen atij pavarësisht kalimit të



mëpasshëm të pronësisë së kuotave me të cilat lidhet njoftimi për pagesë.

6.2 Në rast se pas njoftimit për shlyerjen e kontributeve pagesa përkatëse nuk kryhet brenda afatit të parashikuar, personi përgjegjës për shlyerjen e kontributeve do të paguajë një interes mbi shumën e papaguar me një kamatëvonesë duke filluar nga dita e parashikuar për pagesën. Përlllogaritja e kamatëvonesave do të bëhet sipas ligjit në fuqi.

6.3 Në rast se pas njoftimit për shlyerjen e kontributeve, pagesa përkatëse nuk kryhet brenda afatit të parashikuar, Administratori njofton paraprakisht të pakten 14 (katërbëdhjetë) Ditë të Plota personin përgjegjës për shlyerjen e kontributeve, duke i kërkuar pagesën e shumës së pashlyer së bashku me shumat e mundshme shtesë të kamatëvonesës. Njoftimi do të përmbajë vendin ku duhet të kryhet pagesa dhe deklarin se në rast moszbatimi të tij, kuotat të cilave u referohet njoftimi do të anulohen.

6.4 Nëse pagesa nuk kryhet brenda afatit të njoftimit, kuota me të cilin lidhet njoftimi, përpara se të kryhet pagesa e kërkuar sipas njoftimit, mund të anulohet me vendim të Asamblese së Përgjithshme dhe anulimi do të përfshijë të gjithë dividendët ose shumat e tjera të pagueshme në lidhje me kuotat e anuluar dhe të papaguara deri në momentin e anulimit.

6.5 Në pajtim me dispozitat ligjore, kuota e anuluar mund të shitet, rishperndahet ortakeve ose të kalohet sipas afateve dhe menyrave që Asambleja e Përgjithshme konsideron të pershtatshme.

6.6 Personi, kuota e të cilit është anuluar, humbet çilesinë e ortakut në lidhje me këto kuota por do të jete përgjegjës ndaj shoqërisë për të gjitha kontributet që do të shlyeshin nga ky ortak ndaj shoqërisë në datën e anulimit të kuotes së bashku me kamatëvonesën e llogaritur për këto kontribute përpara anulimit të kuotes.

## **Neni 7**

### **Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit**

7.1 Kapitali i shoqërisë mund të zmadhohet nëpërmjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyrë, nëpërmjet emërimit nga asambleja e përgjithshme e një eksperti të autorizuar për këto kontribute sipas kërkesës së administratorit.

7.2 Zvogëlimi i kapitalit lejohet nga asambleja e ortakëve, e cila vendos në të njëjtat kushte që kërkohen për modifikimin e statutit.

7.3 Në të gjitha rastet zvogëlimi prek kapitalin e ortakëve në të njëjtën masë të pjesëve të kapitalit që ata përfaqësojnë.

## **Neni 8**

### **Transferimi i kapitalit**

8.1 Kuotat e kapitalit dhe të drejtat që rrjedhin prej tyre janë lirisht të transferueshme si në rastet më poshtë:

- në rastin e ortakut person fizik, për efekt të trashëgimisë në rast vdekje apo nëse transferohen të bashkeshorti apo pasardhës të ortakut;
- në rastin e ortakut person juridik nëse transferimi bëhet të ortakët e shoqërive pjesëmarrëse (filialet) apo të lidhura me ortakun person juridik. Ky rast parashikon edhe mundësinë e operacioneve të mundshme të transformimit, bashkimit apo ndarjes dhe blerjeve së shoqërive.

8.2 Ortaku që kërkon të bëjë transferimin e kuotave, duhet t'ia ofrojë ato ortakëve të tjerë të shoqërisë me të njëjtat kushte të cilat do t'ua ofronte të tretëve, të cilët duhet të shprehen me shkrim brenda 10 (dhjetë) ditëve nga oferta, nëse do të shfrytëzojnë të drejtën e parablerjes ose jo. Nëse ortakët nuk shprehen me kalimin e afatit, konsiderohet se kanë refuzuar.



### Kreu III Organet e Shoqërisë

#### Neni 9

##### Organi Vendimmarrës

9.1 Asambleja e Ortakëve është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë.

9.2 Asambleja e Ortakëve është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë që miraton cdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të përcaktuara në ligj.

9.3 Asambleja e përgjithshme e ortakëve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme:

- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- d) emërimin e shkarkimin e likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- e) përcaktimin e shperblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" dhe "d" të kësaj pike;
- f) ekzaminimin e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë të përgatitur nga administratorët;
- g) miratimin e pasqyrave financiare vjetore;
- h) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- i) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- j) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- k) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- l) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- m) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

9.4 Ortaku mund të përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme, në bazë të një autorizimi me shkrim, nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë. Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

9.5 Administratori i shoqërisë nuk mund të veprojë si përfaqësues i ortakëve në asamblenë e përgjithshme.

#### Neni 10

##### Thirrja e mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme

10.1 Asambleja e përgjithshme thirret në rastet e parashikuara nga Ligji, nga Statuti dhe cdo herë që asambleja bëhet e nevojshme për të mbrojtur interesat e shoqërisë.

10.2 Asambleja e përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë në adresën fizike ose, me njoftim nëpërmjet postës elektronike në adresën e e-mailit ose nëpërmjet një mesazhi elektronik në platforma të komunikimit elektronik që u dërgohet të gjithë ortakëve. Adresat dhe numri i telefonit për secilin ortak janë deklaruar në nenin 22 të këtij Statuti. Njoftimi dërgohet të paktën 7(shtatë) ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e Asamblesë.

10.3 Njoftimi duhet të përmbajë informacion mbi tipin e asamblesë, vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës për thirrjen e parë dhe thirrjen e dytë. Asambleja mund të thirret edhe jashtë selisë së Shoqërisë, në Greqi ose në Shqipëri.

10.4 Asambleja do të thirret dhe do të mbahet rregullisht edhe kur nuk janë respektuar formalitetet e njoftimit të saj, në momentin kur, janë prezent ortakët, të cilët përfaqësojnë kapitalin e plotë social.



10.5 Ortakët mund të marrin pjesë në Asamble edhe nëpërmjet telekonferencës ose nëpërmjet përdorimit të mjeteve të tjera elektronike me kusht që të jenë të identifikuar të gjithë të pjesëmarrësit dhe të jetë e mundur që të ndjekin diskutimin dhe të marrin pjesë drejtëpërsëdrejti në trajtimin e rendit të ditës si dhe të kenë mundësi të shqyrtojnë apo të marrin dokumentacionin dhe ta transmetojnë atë dhe në fund të marrin rregullisht pjesë në votim dhe në vendimarrje.

## **Neni 11**

### **Kuorumi**

11.1 Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote që zotërojnë më shumë se 30 për qind të kuotave.

11.2 Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çështje që kanë të bëjnë për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë, asambleja mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse ortakët që zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë, apo mjete elektronike.

11.3 Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mbledhet për shkak të mungesës së kuorumit të përmendur më lart, asambleja mbledhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

## **Neni 12**

### **Marrja e vendimeve**

12.1 Asambleja e përgjithshme vendos me tri të katërtat e votave të zoteruesve të kuotave të kapitalit, të ortakeve pjesëmarrës, për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

12.2 Asambleja e përgjithshme vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës, për çështje të tjera si:

- a) përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë;
- b) emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
- c) emërimin edhe shkarkimin e likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- d) mbikeqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- e) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- f) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;

12.3 Cdo ndryshim statuti duhet të depozitohet pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB) për të pasqyruar ndryshimet në ekstraktin e shoqërisë.


## **Neni 13**

### **Administrimi**

12.1 Administratorët kanë të drejtat dhe kompetencat për administrimin e përgjithshëm dhe të vecantë të Shoqërisë brenda limiteve që vendos Ligji, ky Statut dhe kompetencat që i përkasin asamblesë së ortakëve.

12.2 Administratori i Shoqërisë është: Neritan Malo, me Nr ID G910021340 lindur në ELBASAN më 02.10.1969, i cili emërohet për një periudhë 5(pesë) vjecare;

Nënshkrimi i administratorit:





## Neni 14

### Kompetencat e Administratorëve

Detyrimet e administratorëve:

- a) Të kryejnë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga Asambleja e Përgjithshme;
- b) Të përfaqësojnë shoqërinë tregtare; Përfaqësimi ligjor i shoqërisë është i vlefshëm për çdo veprim gjyqësor apo jashtëgjyqësor
- c) Të kujdesen për mirëmbajtjen korrekte të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- d) Të përgatisin dhe nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;
- e) Të krijojnë një sistem kontrolli mbi rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- f) Të kryejnë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, si parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;
- g) Të raportojnë përpara Asamblesë së Përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të vecantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
- h) Të marr vendime të cilat kanë të bëjnë me ndryshimin e adresës/save të shoqërisë, duke përfshirë këtu dhe selinë qendrore;

## Neni 15

### Përgjegjësitë e Administratorit

15.1 Administratori është përgjegjës individualisht, ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve, për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit, apo për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.

15.2 Me përjashtim të rasteve të parashikuara në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 të ligjit "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", administratori detyrohet:

- a) të kryejë detyrat e tij të përcaktuara në ligj dhe në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë në tërësi, duke i kushtuar vëmendje të vecantë ndikimit të veprimtarisë së shoqërisë në mjedis;
- b) të ushtrojë kompetencat që i njihen në ligj dhe në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita;
- c) të vleresojë me përgjegjësi çështjet, për të cilat merret vendim;
- d) të parandalojë dhe mënjanojë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personale me ata të shoqërisë;
- e) të ushtrojë detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.

## Kreu IV Viti financiar

## Neni 16

### Viti Financiar dhe bilanci vjetor

Viti financiar i Shoqërisë fillon më 1 Janar dhe përfundon më 31 Dhjetor të çdo viti. Përjashtimisht, viti i parë financiar fillon nga data e regjistrimit të shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe mbyllet më 31 Dhjetor të të njëjtit vit.

## **Neni 17**

### **Raporti vjetor**

17.1 Organi administrativ ose, sipas rastit, eksperti kontabël paraqet raportin financiar vjetor brenda 3(tre) muajve të vitit ushtrimor pasardhës.

17.2 Raporti përmban informacione mbi shpenzimet, të ardhurat dhe cdo lloj informacioni financiar tjetër mbi shoqërinë.

17.3 Asambleja miraton bilancin dhe llogaritë financiare të ushtrimit brenda 6 muajve të pare në vitin ushtrimor pasardhës.

## **Kreu V**

### **Prishja-riorganizimi i shoqërisë**

## **Neni 18**

### **Prishja dhe likuidimi**

Shpërndarja ose prishja e shoqërisë mund te bëhet në cdo kohë me:

- a) me vendim të Asamblesë së ortakëve;
- b) me hapjen e procedurave të falimentimit;

## **Neni 19**

### **Riorganizimi i shoqërisë**

Shoqëria mund të ndahet, bashkohet sipas Vendimit të Mbledhjes së Përgjithshme të Asamblesë së Ortakëve, në përputhje me dispozitat ligjore të parashikuara në pjesën IX të Ligjit 9901 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, të ndryshuar.

## **Neni 20**

### **Baza Ligjore**

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje të plotë me këtë statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

Për sa nuk parashikohet në këtë statut, do të zbatohen dispozitat e ligjit “Per tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, Kodit Civil dhe cilido ligj tjetër që aplikohet në Republikën e Shqipërisë.

## **Neni 21**

### **Mosmarrëveshjet**

Per mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me zbatimin apo interpretimin e këtij statuti, si dhe për cdo mosmarrëveshje që mund të lind midis Shoqërisë dhe palës së tretë, do të jetë kompetente Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

## **Neni 22**

### **Komunikimet dhe njoftimet**

Adresat ku bëhen njoftimet dhe komunikimet midis ortakëve janë si më poshtë:

-Neritan Malo (adresa fizike) -Autostrada Tirane Durres Ruga Pavarsia nr 127 (e-mail) [neritan@izoterm.al](mailto:neritan@izoterm.al)  
nr tel- 0692093807



- Konstantinos Ydraios, (adresa fizike) -Anapafesos 110 Gerakas Attica P.O 110 Athens Greece (e-mail) [kostas.ydraios@yahoo.gr](mailto:kostas.ydraios@yahoo.gr) nr tel 0030 6956290690

-Stylios Ydraios, (adresa fizike)- Matzarou 16 Megara Greece (e-mail) [stilianosidraios@gmail.com](mailto:stilianosidraios@gmail.com) nr tel 0692063069

-Mirela Malo, (adresa fizike) - Arachovis 12, Melissa Athens Greece (e-mail) [mirelamalou@yahoo.com](mailto:mirelamalou@yahoo.com) nr tel 0030 69 56 20 5922

**Neni 23**


**Kopjet**

Ky Dokument u redaktua në 1(nje) kopje origjinale në gjuhën shqipe.

Lexuar, miratuar, konfirmuar dhe nënshkruar nga ortakët themelues.

### **ORTAKËT THEMELUES**

**Neritan Malo**



**Konstantinos Ydraios**

**Stylios Ydraios**

**STILIANOS YDRAIOS**



**Mirela Malo**

Nënshkruar më 18.12.2023.